

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.GJ., nga fshati ... Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor , nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-ës, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë e të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.1149/17, datë 08.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.1149/17, datë 08.05.2018, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin P.nr.1149/17, me datë 08.05.2018, të akuzuarin E.GJ. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-ës, e ka shpallë fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim me kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, e të cilin dënim i akuzuari fare nuk do ta vuajë nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 15 (pesëmbëdhjetë) € kurse në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 20 (njëzet) €, 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket dënimin dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të ashpër dhe atë dënim me burg efektiv.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.56/2019, datë 21.01.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i ashpër dhe atë dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin për të kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Prokurori sa i përket vendimit mbi dënimin, në ankesë ka pretenduar se Gjykata me rastin e shqiptimit të këtij dënimi ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese të cekura si më lart dhe nuk ka pasur parasysh se vepra e tillë penale nga neni 188 par.2 të KPRK-së, hyn në kapitullin e veprave penale kundër jetës dhe trupit, e që në rastin konkret i pandehuri me veprimet e veta ka cenuar integritetin trupor të personit të personit tjetër, vlerë kjo e garantuar me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe vendore, si dhe pasur parasysh rrethanat në të cilat është kryer vepra penale si dhe mënyrën e kryerjes dhe atë me mjet që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor (boks i hekurit) ku kjo nga ana e gjykatës nuk është marrë fare parasysh si rrethanë rënduese, andaj konsideron se dënimi nuk është në proporcion me peshën e veprës penale si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit të lartcekur, jo vetëm që nuk është në proporcion me peshën e veprës penale, pasojat e shkaktuara, por i njëjti nuk do të arrijë qëllimin dhe efektin e një dënimi meritor, si dhe nuk do të shërbejë si preventivë për sigurinë e përgjithshme.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit të shtetit për një dënim më të ashpër nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, në rastin konkret gjykata për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari ka qenë pranimi i singhtë

i fajësisë, pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshme rinë e mëparshme, moshën e re, gjendjen e rëndë ekonomike- askënd në familje nuk e ka të punësuar, me pranimin e fajësisë ka kontribuar në vërtetimin e gjendjes faktik, ndërsa si rrethanë rënduese ndaj të akuzuarit gjykata nuk ka gjetur dhe të akuzuarit i shqiptoi dënim me kusht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, e gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pretendimi i Prokurorit se dënimi i shqiptuar nuk ka mbështetje ligjore dhe se gjykata nuk ka marrë për bazë rrethanat rënduese në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk është i bazuar, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e me qenë se në ankesën e Prokurorit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re rënduese, e që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe që do të ndikonte në shqiptimin e ndonjë dënimi më të ashpër, si dhe duke marrë parasysh si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe moshën e re të të akuzuarit (madhor i ri) dhe rrethanat e rastit konkret, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikojë në përmbajtjen e peronave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.34/19, datë 13.02.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Shqipe Qerimi